

## Menaxhimi lëndëve ushqyese për mollën

Plehërimi shërben për të mbështetur rendimentin e pemëtores, për të arritur cilësinë e kërkuar të frutave nga tregu dhe për të zëvendësuar elementët ushqyes të larguar, me qëllim që të mos varfërohet toka.

Për një strategji korrekte të të ushqyerit të mollës duhet të merren në konsideratë:

Përmbajtja e lëndëve ushqyese të tokës dhe vetitë e tokës

- Nxjerrja e elementëve ushqyese nga kultura
- Funksionet e elementëve ushqyese, periudha e absorbimit maksimal dhe lëvizja e lëndëve ushqyese në tokë dhe në bimë
- Vetitë e plehrave për t'i përdorur ato me eficiencë dhe në mënyrë më korrekte.

**Kur duhen perdoren plehrat ne pemetore?**

| Kur duhet përdorur                         |                                                                                     | Përqindja e përdorimit |               |
|--------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------|------------------------|---------------|
|                                            |                                                                                     | Azoti (N)              | Potasi (K)    |
| 2 javë pas çeljes së sytheve               |  | 30 - 40% e totalit     | 40% e totalit |
| Lidhje e frutave (Lulëzim/rënie e petlave) |  | 30 e totalit           | 30 e totalit  |
| 1 javë pas vjeljes                         |  | 30 - 40% e totalit     | 30 e totalit  |

### Elementët ushqyes të kërkuar

- Makroelementet: N, P, K, Ca, Mg, S
- Mikroelementet: B, Zn, Cu, Mn, Fe, Mo



## Kur duhet të përdor elementet ushqyes në mollët time?

| Kur duhet të përdor elementet ushqyes në mollët time?                             |                                                                                   |                                                                                   |                                                                                   |                                                                                   |                                                                                   |                                                                                    |                                                                                     |
|-----------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------|
|  |  |  |  |  |  |  |  |
| 30% e totalit N                                                                   |                                                                                   |                                                                                   |                                                                                   | 30% e totalit N                                                                   |                                                                                   |                                                                                    | 40% e totalit N                                                                     |
| 40% e totalit K                                                                   |                                                                                   |                                                                                   |                                                                                   | 30% e totalit K                                                                   |                                                                                   |                                                                                    | 30% e totalit K                                                                     |

Plane alternative plehërimi për rendiment 400 kv/ha mollë për pemëtore në toka me pjellori mesatare

| Plehërim mineral me plehra të thjeshtë:   |                                                                                                                  |
|-------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Në vjeshtë                                | Nitrat amoni 26% N ----- 180 kg/ha<br>Superfosfat----- 300 kg/ha<br>Sulfat potasi ----- 280 kg/ha                |
| Në pranverë                               | Nitrat amoni 26% N ----- 280 -360 kg/ha                                                                          |
| Plehërim mineral me plehra të përbërë:    |                                                                                                                  |
| Në vjeshtë                                | Pleh i përbërë 12-12-17 ----- 500 kg/ha<br>Sulfat potasi ----- 110 kg/ha                                         |
| Në pranverë                               | Nitrat amoni 26% N ----- 230 -300 kg/ha                                                                          |
| Plehërim mineral me fosfat biamoni (DAP): |                                                                                                                  |
| Në vjeshtë                                | Fosfat biamoni (DAP) 18- 46 ---- 130 kg/ha<br>Sulfat potasi ----- 280 kg/ha<br>Nitrat amoni 26% N ----- 90 kg/ha |
| Në pranverë                               | Nitrat amoni 26% N ----- 280 -360 kg/ha                                                                          |

## Plehërimi i mollës ka tre objektiva kryesore:

- Përgatitja e bimës për prodhim
- Mbështetje për formimin dhe zhvillimin e frutave
- Përgatitja për vjeljen pasardhëse përmes akumulimit të lëndëve ushqyese rezervë në pemë

Këto objektiva mund të arrihen përmes elementëve të ndryshëm ushqyes që duhet të hidhen me plehra.

Shembull: Për një prodhim prej 600 kv/ha mollë (kundrejt 400 kv/ha rendimenti referuese) faktori korrektues do të jetë  $1.33 (600/ 2 \times 400 +0.5 =1.25)$

Azot:  $120 \times 1.25 = 150 \text{ kg N/ha}$

Fosfor:  $60 \times 1.25 = 75 \text{ kg P}_2\text{O}_5/\text{ha}$

Potas:  $140 \times 1.25 = 175 \text{ kg K}_2\text{O/ha}$